# DËSHMI ARKIVI

**A-454651**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/pas-vendimit-te-hages-prishtina-ngrihet-ne-proteste-policia-kerkondok-i514806` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 10:15:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 10:01:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8945d773dfec01635c39ca4ac39cfd98b0fecee82eea60c289609da4b35e5ce8` |
| TEKSTI | `2372093aa63032c10101ee9b669865e518f46db55be0adbe43ee1ce4a2ba6608` |
| PAMJA | `b60363660ce2cf17069151f7e25326a369629b644bb0d7c33425bc6335eba92f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `508f0e9e0cc57966dda58839a4396516b94ca4a9e0e017294e892e0f7bbd9038` |
| E MËPARSHMJA | `c3d03b466372673d796c9bffbfd72dba56cbd04e75844a941c486ccfc6d6cb02` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/508f0e9e0cc57966dda58839a4396516b94ca4a9e0e017294e892e0f7bbd9038`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

4 ORE ME PARE
111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

11 ORE ME PARE
Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

14 ORE ME PARE
"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkosh rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

1 DITE ME PARE
110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mblidhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

LIVE UPDATES

# Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

• Ditën e sotme në Prishtinë është mbajtur protesta e thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë e cila dënoi me 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-së. • Protesta ka nisur në orën 12:00 në sheshin "Skënderbeu" dhe gjatë zhvillimit ka qenë paqësore. • Thirrja për protestë u bë një ditë më parë nga Gazmend Syla i OVL-UÇK-së, i cili tha se vendimi është marrë pas takimit të Këshillit Drejtues të organizatës. • Në lidhje me këtë, Policia e Kosovës ka marrë masa të rrepta për garantimin e rendit dhe sigurisë gjatë protestës. • Ajo u ka bërë thirrje pjesëmarrësve të jenë të qetë, të respektojnë udhëzimet e zyrtarëve dhe të shmangin çdo veprim që mund të cenojë sigurinë publike. • Në nisje të saj protesta u shoqërua me tensione dhe përplasje, pasi policia kërkoi dokumentet e identifikimit për pjesëmarrësit. • Kjo kërkesë shkaktoi reagime dhe debate mes efektivëve dhe qytetarëve, të cilët e kanë kundërshtuar këtë veprim. • Nga ana tjetër, Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë ka paralajmëruar shtetasit amerikanë për protestën e cila do të zhvillohet ditën e sotme në Prishtinë. • Përmes një njoftimi zyrtar, ajo u ka bërë thirrje shtetasve amerikanë që ndodhen në Kosovë që të shmangin tubimin në sheshin "Skënderbeu", duke shtuar se tubimet mund të shoqërohen me grumbullime të mëdha njerëzish, bllokime të rrugëve dhe vështirësi të konsiderueshme në qarkullimin rrugor në zonat përreth. • Protesta është paralajmëruar në Prishtinë pas dënimit me 81 vite burg, në total, të disa prej ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, çështje që ka shkaktuar reagime të forta në Kosovë.

5 artikuj për këtë temë.

10 ORE ME PARE

## Protesta në Prishtinë/ Djali i Jakup Krasniqit: Nuk duhet të dorëzohemi, ajo që ndodhi në Hagë prek sakrificën e çdo dëshmori (VIDEO)




Jakup Krasniqi

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 17:07
Doli nga qelia dhe shkoi në spitalin Salus/ Veliaj kishte thyer këmbën duke luajtur

**PRISHTINA**- Djali i Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi i është bashkuar protestës së mbajtur sot në sheshin në Prishtinë në mbështetje të UÇK. Gjatë fjalës së tij para pjesëmarrësve, ai është shpehur se ajo që ndodhi në Hagë, prek sakrificën e çdo dëshmori, çdo veterani dhe çdo të zhdukuri familjet e të cilëve ende e kërkojnë trupat e tyre.



Ai theksoi se familjet dhe mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së, nuk duhet të dorëzohen, duke shtuar se do të vazhdojnë të kërkojnë drejtësi. Në fund, ai i bëri thirrje partive politike ta lënë anash poltikën dhe të bëhen bashkë në lidhje me këtë rast.

*"Sot janë jo vetëm si biri i njeriut që po i bëhet padrejtësi, por si biri i këtij populli. Ajo që ndodhi në Hagë, prek sakrificën e çdo dëshmori, çdo veterani, çdo të zhdukuri familjet e të cilëve ende e kërkojnë. Sot nuk duhet të dorëzohemi sepse nëse ne dorëzohemi do të na gjykojë jo vetëm historia por edhe e ardhmja. Për 6 vjet kemi kërkuar drejtësi dhe do vazhdojmë të kërkojnë drejtësi. Sot i bëjmë thirrje edhe të gjithë partive politike të lëmë anash të gjitha dallimet dhe le të bëhemi bashkë"*, tha ai./**Dosja.al**

10 ORE ME PARE

# Protesta në Prishtinë/ Djali i Kadri Veselit: Nuk e kemi humbur besimin te bota perëndimore dhe drejtësia e tyre (VIDEO)




futboll në paraburgim, sot shkoi për të bërë grafinë

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 20:00
FOTO/ Aksidenti në Athinë, këta janë tre të rinjtë që humbën jetën tragjikisht

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 19:20
Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në vepra të paligjshme

**më të klikuarat**

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

Pagat e magjistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

Takimi sekret në Buenos Aires/ Mediat urugaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon

**insights**

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka



Klestor Veseli

**PRISHTINA-** Djali i ish-kryetarit të Kuvendit, Kadri Veseli po merr pjesë në protestën e cila po zhvillohet në Prishtinë. Gjatë një prononcimi për mediat, Klestor Veseli u shpreh se nuk e ka humbur besimin te bota perëndimore dhe drejtësia e saj. Ai theksoi se familjet dhe mbështetësit e ish-krerëve të UÇK-së po kërkojnë korrigjim të një gabimi që ka qenë i zhytur në politikë.



*"Nuk e kemi humbur besimin te bota perëndimore, tek drejtësia e tyre. Ne vetëm po kërkojmë korrigjim të një gabimi që ka qenë i zhytur në politikë. Faleminderit edhe juve që po i kushtoni vëmendje kësaj pune"*, tha Veseli./**Dosja.al**

11 ORE ME PARE

# Protesta në Prishtinë/ Ambasada amerikane: Shmangni sheshin "Skënderbeu"




Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.io

Foto ilustruse

**PRISHTINA**- Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë ka paralajmëruar shtetasit amerikanë për protestën e cila do të zhvillohet ditën e sotme në Prishtinë. Përmes një njoftimi zyrtar, ajo u ka bërë thirrje shtetasve amerikanë që ndodhen në Kosovë që të shmangin tubimin në sheshin "Skënderbeu", duke shtuar se tubimet mund të shoqërohen me grumbullime të mëdha njerëzish, bllokime të rrugëve dhe vështirësi të konsiderueshme në qarkullimin rrugor në zonat përreth.

Protesta është paralajmëruar në Prishtinë pas dënimit me 81 vite burg, në total, të disa prej ish-drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, çështje që ka shkaktuar reagime të forta në Kosovë. Ambasada amerikane thekson se situata mund të sjellë kufizime në qarkullim dhe grumbullime të mëdha në qendër të kryeqytetit gjatë orëve të protestës.**/Dosja.al**

12 ORE ME PARE

# Ndizen tensionet në Prishtinë pak para nisjes së protestës/ Policia kërkon dokumentet e identifikimit të pjesëmarrësve, qytetarët kundërshtojnë (VIDEO)



Pamje

**PRISHTINA**- Protesta e paralajmëruar në Prishtinë është shoqëruar me tensione dhe përplasje, pasi policia ka kërkuar dokumentet e identifikimit për pjesëmarrësit. Kjo kërkesë ka shkaktuar reagime dhe debate mes efektivëve dhe qytetarëve, të cilët e kanë kundërshtuar këtë veprim.



[redacted]

Protesta është thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila është parashikuar të nis në orën 12:00, në sheshin “Skënderbeu”, duke theksuar se ajo do të jetë paqësore. Nga ana tjetër, Policia e Kosovës ka marrë masa të rrepta për garantimin e rendit dhe sigurisë gjatë protestës. Ajo u ka bërë thirrje pjesëmarrësve të jenë të qetë, të respektojnë udhëzimet e zyrtarëve dhe të shmangin çdo veprim që mund të cenojë sigurinë publike./**Dosja.al**

---

13 ORE ME PARE

# “O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke”/ Shkuan

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.